



Nr.regj.42402/11

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, me gjyqëtar Murat Paçaradën dhe sek.juridik Naim Thaqi duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurës Shpresa Hasaj-Hyseni nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 3, neni 5.parg.1 dhe 1.1, neni 15 parag.4, e lidhur me neni 17 parag.1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen, dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarve të Lartë Publik, e në bazë të neni 73.74.195, dhe 199 të Ligjit mbi kundërvajtjet, me dt.23.12.2011 merrë këtë,

A K T V E N D I M

E PANDEHURA: Shpresa Hasaj-Hyseni e lindur me 01.04.1958 në Pejë, tani jetonë në Prishtinë, Lagja Ulpiana, Rr" Muj Krasniqi" hyrja e parë, numer 14, e maruar, nënë e dy fëmijëve, e gjendjes së mesme ekonomike, ka të krye fakultetin, Gjyqtare në Gjykatën Komunale në Prishtinë

Ë s h t ë p ë r g j e g j e s

Sepse si Gjyqtare në Gjykatën Komunale në Prishtinë, nuk e ka bërë deklarimin e plotë të pasurisë pranë Agjencionit Kundër Korrupsionit në afatin e caktuar ligjor, edhe pse ka qenë i njohtuar se është përfshirë në Listen e Zyrtarve, të cilët janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë e plotë që e posedojn. Gjatë kontrollit nga agjencioni Antikorrupsion i janë gjetur dy paluejtëshmeri në emër bashkëshortit të saj në sipërfaqe prej 4321 m², dhe 10852 m², të cilat paluejtëshmeri janë të evidentuara në Zyrën Katastrale në Pejë

Me veprim të këtill ka kryer kundërvajtje nga neni 3, neni 5.parg.1 dhe 1.1, neni 15 parag.4. lidhur me neni 17 parag.1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë, dhe Dhuratave të Zyrtarve të Lartë publik, andaj për këtë:

D E N O H E T

Me gjobë në të holla në shumë prej **1000 (njëmij) Euro**, të cilën gjobë ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktvendimi merr formën e prerë. Në dobi të të hyrave Gjyqësore të Kosovës, në Prishtinë në xhir. Rrjedh nr. 1000430070000518.

Nëse gjoben e shqiptur nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjta do ti zëvendësohet në denim me burgimi në kohëzgjatje prej 30 ditësh duke ju llogaritur 15 EURO në një ditë burgimi.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur. Në emer të paushallit gjyqësor e pandehura është i obliguar të paguaj shumën prej 5 EURO, në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën.

Pagesa e gjobes bëhet në të gjitha bankat e qytetit, kurse paushalli gjyqësorë në arkën e gjykatës Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dërgohet të pandehurës dhe parashtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencioni Kundër Korrupsionit në Prishtinë, me kërkesën nr.01-4696/11 të parashtruar gjykatës me datën 05.12.2011 për inicimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurës të permendur me lartë, për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata duke vepruar sipas kërkesës, ka zhvilluar procedurën kundërvajtëse dhe në seance verbale ka ndërgjuar të pandehurën i cili në mbrojtjen e vet deklaroi: Është e vertet se gjatë deklaramit të pasurisë për vitin 2010 është gjetur nga Zyra Katsrale në Pejë, se unë nuk e kam deklarue pasurinë e cila ka qenë mbi bashkëshortin tim dhe ate me sipërfaqe prej 4321 m² dhe tjetra 10852 m². Shtoj se ajo pasuri është e

Agush Ismajli, pas asaj neve na del diku një e gjashta e pasurisë, prandaj nuk e kam parë të arsyeshme ta deklaroj këtë pasuri, nga se ende nuk e di se sa do të na takoj, prandaj nuk e ndiej vehten fajtores për mosdeklarimin e kësaj pasurie. Shtoj se Agjencioni Antikorrupsion kur gjenë pasuri ose parregullësi në formularin për deklarimin e pasurisë është i obliguar që ta thëras parashtruesin dhe të kërkoj sqarime lidhur me deklarimin e asaj pasurie të gjetur jashta formularit.

Për sqarimin e kësaj çeshtje gjykatësi thirri në cilësin e deshmitarit përfaqësuesin e kërkeses për hapjen e procedurës Agron Behramin Shef i divizionit për Mbikqytjen e Pasurisë dhe Dhuratave në Departamentin e Parandalimit në Agjencioni Antikorrupsion i cili deklaroi: Se Agjencioni kur gjenë ndonjë gabim material ose plotësim të gabuar në formularë e thret deklaruesin që afatin prej 15 ditësh të vije në Agjencion dhe të bëjë përmirësimin e atyre gabimeve, ndërsa sa i përket mosdeklarimit të pasurisë të ndonjë pjese të pasurisë Agjencioni nuk është i obliguar që ta njohtoj deklaruesin e pasurisë sepse ai ka qenë i obliguar që të njejtën ta deklaroj në formularë. Ne gjatë kontrollit të plotë të pasurisë kemi vrejtur se e njejtë nuk e ka bërë deklarimin e pasurisë dhe atë në sipërfaqe prej 4321m² si dhe një tjetër pasuri në sipërfaqe prej 10852m², e cila pasuri është e regjistruar në emer të bashkëshortit, dhe kjo është vertetuar nga Çertifikat Katastrale, e Zyrës Kastarle në Pejë.

Gjykatësi pas vlersimit të mbrojtjes së të pandehurës, deklaratës së deshmitarit, dhe provave të paraqitura nga institucioni përkatës, si dhe shkresave tjera të lëndës, erdhi në përfundim se e pandehura e ka kryer kundërvajtjen e cila e ngarkon, dhe se duhet të përgjigjet për kundërvajtjen të cilën e ka bërë.

Me rastin shqiptimit dhe caktimit të lartësisë së gjobës gjyqtari vlersoj të gjitha rrethanat nga neni 7 i LMK-së nën të cilat është krye kundërvajtja, dhe të pandehurës ia shqiptoj kë lloj gjobe duke llogaritur se edhe me këtë lloj denimi do të arrihet efekti i sanksionimit, duke llogaritur që e pandehuar në të ardhmen të mos kryej kundërvajtje të këtilla ose të ngjajshme

Konform neni 109 al.2 të LMK-së caktohen shpenzimet e procedurës kundërvajtëse.

Me sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë Gjykatës së Lartë për kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditë që nga dita e marrjes së aktvendimit e nëpërmes kësaj Gjykate.

VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË.

Gjyqtari
Murat Paçarada



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. _____	Nr. Prot _____
Dep. <u>D-P</u>	Isr. Prot. <u>03-5147/11</u>
Nr. i faq. _____	Data _____
Broj stranica _____	Datum <u>30.12.2011</u>
Nr. pages _____	Date _____
PRISHTINË	